

V E N D I M
Nr.405 datë 31.8.1999

**PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND PA ÇMIM FILLESTAR TË
PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË DISA SHOQËRIVE TREGTARE QË
VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË**

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin, mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ligjit nr.8159, datë 7.11.1996 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1632, datë 1.11.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Privatizimin nëpërmjet ankandit pa çmim fillestar të paketave shtetërore të aksioneve të disa shoqërive tregtare.

Shoqëritë tregtare, paketat shtetërore të aksioneve të cilave do të privatizohen nëpërmjet ankandit pa çmim fillestar sipas këtij vendimi, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Transferimi i aksioneve të bëhet nëpërmjet ankandit pa çmim fillestar. Mekanizmi i zhvillimit të ankandit pa çmim fillestar funksionon në bazë të raportit kërkesë-ofertë.

Me kërkesë do të kuptojmë çmimin e ofruar për paketën e aksioneve të shoqërisë nga pjesëmarrësi në ankand.

Me ofertë do të kuptojmë kapitalin themeltar të paketës së aksioneve të shoqërisë së ofruar për shitje.

Në ankandin pa çmim fillestar të gjithë pjesëmarrësit paraqesin në zarf të mbyllur ofertën me shkrim, e cila shpreh çmimin e plotë të ofruar për paketën e aksioneve të shpallur për shitje. Kjo ofertë shoqërohet me garancinë bankare të pagesës së kryer për 30 për qind të çmimit të ofruar.

3. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit i paraqet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në origjinal e sipas formës së kërkuar nga ligji dokumentacionin, i cili duhet të jetë i përgatitur në një afat jo më shumë se tre muaj përpara datës së nxjerrjes së urdhrit të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Dokumentacioni të përmbajë :

- Urdhrin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për privatizimin me ankand pa çmim fillestar të paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare;

- vendimin e regjistrimit të shoqërisë tregtare në regjistrin tregtar;

- aktin e themelimit të shoqërisë tregtare;

- statutin e shoqërisë;

- bilancin e fundit të aktivitetit të shoqërisë dhe raportin e ekspertit kontabël;

- vleftën e paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare që ofrohet për shitje;

- strukturën e pronësisë së shoqërisë tregtare;

- genplanin, planimetrinë dhe akt-vlerësimin e truallit të shoqërisë;

- përshkrim përmbledhës me të dhënat kryesore të shoqërisë tregtare që privatizohet, i cili përmban :

- emrin e shoqërisë

- datën e krijimit

- sferën e aktivitetit

- një listë të pasurisë së paluajtshme në përdorim të shoqërisë

- kohën e veprimtarisë

- detyrimet debitore e kreditore të shoqërisë

- numri i punonjësve të shoqërisë

- paraqitja e detyrimeve tatimore nga autoritetet kompetente.

4. Me mbërritjen e urdhrave, Agjencia Kombëtare e Privatizimit bën publikimin për

privatizimin e paketave shtetërore të shoqërive tregtare.

5. Periudha e publikimit do të jetë jo më pak se 30 ditë nga data e parë e publikimit. Publikimi do të bëhet 6 herë në tri gazeta me qarkullim kombëtar, përkatësisht nga dy herë në secilën gazetë.

6. Objekt publikimi do të jetë :

- emri i shoqërisë
- selia
- paketa e aksioneve në përqindje dhe në vleftën nominale
- objekti i veprimtarisë
- sipërfaqja e truallit të shoqërisë
- data, ora dhe vendi i zhvillimit të ankandit.

7. Çdo personi juridik apo fizik të interesuar për të marrë pjesë në ankand, gjatë periudhës së publikimit i krijohet mundësia të njihet me dosjen e shoqërisë, e cila ndodhet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, si dhe mund të marrë informacion në shoqërinë që privatizohet. Pjesëmarrja në ankand pa u njohur me dosjen e shoqërisë, është në përgjegjësinë e subjekteve pjesëmarrëse.

8. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në zarf të mbyllur para komisionit të ankandit dokumentacionin vijues :

- Çmimin që ofrojnë për blerjen e paketës së aksioneve të shoqërisë;
- dokumentet ligjore identifikuese të personave fizikë ose juridikë;
- dokumentin bankar që vërteton ngrirjen, për periudhën deri në përfundim të ankandit, të pagesës paraprake me lekë, urdhërxhirimi apo garancisë bankare, me 30 për qind të vlerës që ofrojnë për paketën e aksioneve të shoqërisë, në favor të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në llogarinë nr.4302, dega e thesarit Tiranë.

9. Komisioni i ankandit përbëhet nga:

- Kryetar - përfaqësuesi i AKP-së
- anëtar- juristi i AKP-së
- anëtar- përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit
- anëtar- përfaqësuesi i shoqërisë tregtare që privatizohet
- anëtar - përfaqësues i organit administrativ të linjës
- sekretar - punonjës i AKP-së, pa të drejtë vote.

10. Pjesëmarrja në komision në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e ankandit është e detyrueshme për të gjithë anëtarët. Titullarët e organeve të përmendura në pikën 9 të këtij vendimi, ngarkohen me përgjegjësi për pjesëmarrjen e anëtarëve në komisionin e ankandit.

11. Komisioni i ankandit ka këto detyra :

- Të sigurojë që para nisjes së ankandit, nëse gjithë pjesëmarrësit në ankand janë të regjistruar dhe identifikuar sipas dokumenteve që kërkon ligji dhe të nënshkruajë me secilin pjesëmarrës marrëveshjen mbi kushtet për privatizimin e paketës së aksioneve;

- të paraqesë anëtarët e komisionit të pjesëmarrësit;
- të deklarojë fillimin e ankandit;
- të hapë në prani të pjesëmarrësve në ankand zarfet e depozituar prej tyre;
- të shprehë me zë duke treguar para secilit pjesëmarrës ofertat e dhëna prej tyre;
- të bëjë renditjen e ofertave nga më e larta te më e ulta;
- të shpallë fituesin, i cili ka ofruar vleftën më të lartë të paketës së aksioneve të shoqërisë, në prani të pjesëmarrësve në ankand;

-të hartojë dokumentacionin për ecurinë e ankandit, që përbëhet nga procesverbali dhe raporti për përfundimin e ankandit. Ky dokumentacion nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të ankandit dhe fituesi i tij.

12. Ditën e ankandit, fituesi merr nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit autorizimin për shitjen e paketës së aksioneve të publikuara për shitje, ku përcaktohen kushtet që duhen plotësuar nga ai, para nënshkrimit të kontratës së shitjes. Në këtë autorizim përcaktohet detyrimi që fituesi i ankandit është i detyruar të bëjë pagesën e plotë, brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit.

13. Pjesëmarrësve të tjerë i kthehet vlefë fillestare prej 30 përqindëshi i ngurtësuar paraprakisht.

14. Fituesit të ankandit, që nuk kryen pagesën brenda afatit të përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi, si dhe kur ai tërhiqet brenda këtij afati, i mbahet vlefë fillestare e ngurtësuar. Në vazhdim, procedura rifillon nga pika 5 e këtij vendimi.

15. Nga vlera e shitjes së realizuar të paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare, 5 për qind e saj kalon për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit. Kjo shumë, në rastet kur fituesi i ankandit nuk kryen pagesën e plotë sipas autorizimit të përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi, mbahet nga 30 përqindshi i paguar paraprakisht prej tij.

16. Vetëm kur blerësi plotëson kushtet e autorizimit sipas pikës 12 të këtij vendimi, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidh me të kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të shoqërisë të publikuar për shitje.

17. Në rast se në ankandin e shpallur nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës, AKP-ja njofton Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe pret një urdhër të ri të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

18. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko